



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M
Nr.1448, datë 18.11.2010

Për

“Njoftimin e fituesit të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e 1 (një) të drejte përdorimi në brezin e frekuencave 1920-1935 MHz çiftuar me 2110-2125 MHz dhe 1900-1905 MHz spekter i paçiftuar që ofrojnë shërbime me brez të gjerë”.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 12.11. 2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Njoftimi i fituesit të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e 1 (një) të drejte përdorimi në brezin e frekuencave 1920-1935 MHz çiftuar me 2110-2125 MHz dhe 1900-1905 MHz spekter i paçiftuar që ofrojnë shërbime me brez të gjerë”.

BAZA LIGJORE:

1. VKM Nr.1252 datë 10.09.2008 pika 1.3 “Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave” i ndryshuar me VKM Nr.501 datë 09.06.2010 “Për disa ndryshime në vendimin Nr.1252 datë 10.09.2008 të Këshillit të Ministrave”;

2. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

- Raporti përmbledhës i procedurës së tenderit publik protokolluar me nr.2839/15, datë 17.11.2010
- Projektvendim i KD i formatuar dhe arsyetuar;
- Njoftimi i fituesit sipas shtojces 16-Formulari i Njoftimit te Fituesit
- Shtojca 17- Formulari i Botimit te Fituesit
- Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Dokumentacioni:

- a) **Raporti përmbledhës** i hartuar nga KVO është në përputhje me piken 15.10, Kreu III të VKM nr.1252, datë 10.09.2008 “Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave” i ndryshuar me VKM Nr.501 datë 09.06.2010 “Për disa ndryshime në vendimin Nr.1252 datë 10.09.2008 të Këshillit të Ministrave”;
- b) **Procedura e ankimit ka përfunduar dhe nuk janë paraqitur ankime.**
- c) **Shtojca 16- Formulari i Njoftimit te Fituesit** të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “*Dhënia e 1 (një) të drejte përdorimi në brezin e frekuencave 1920-1935 MHz çiftuar me 2110-2125 MHz dhe 1900-1905 MHz spekter i paçiftuar që ofrojnë shërbime me brez të gjerë*” është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës.
- d) **Shtojca 17- Formulari i Botimit te Fituesit** është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës dhe me Dokumentin e Tenderit.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë:

- VKM Nr.1252 datë 10.09.2008 pika 1.3 “Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave” i ndryshuar me VKM Nr.501 date 09.06.2010 “Për disa ndryshime në vendimin Nr.1252 datë 10.09.2008 të Këshillit të Ministrave”;
- Dokumentin e Tenderit;

- Raportin përmbledhës së procedurës së tenderit publik protokolluar me nr.2839/15, datë 17.11.2010, si dhe Pika 17 e nenit 21 të Rregullores së Brendëshme,

V E N D O S:

1. Te miratoje Raportin Permbledhes nr.2839/15, date 17.11.2010.
2. Të miratojë Njoftimin e Fituesit, sipas dokumentit bashkëlidhur.
3. Të njoftohet fituesi i tenderit publik me shkresë zyrtare, sipas dokumentit bashkëlidhur;
4. Të bëhet publikimi i njoftimit të fituesit në faqen e internetit të AKEP, www.akep.al
5. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

A N Ë T A R Ë:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURÇE**